

ABSTRAKT

E DREJTA E GRUAS NË PRONË: KORNIZA LIGJORE DHE PRAKTIKA, ME FOKUS EDHE NË RISITË QË SJELLË DRAFTI I KODIT CIVIL TË KOSOVËS

Kandidate: Kadire Rexha

Mentori: Prof. Ass. Dr. Qerkin Berisha

E drejta në pronë është pjesë përbërëse e çdo sistemi ligjor, përfshirë edhe sistemin ligjor të Republikës së Kosovës, e cila e drejtë garantohet me aktin më të lartë të vendit- Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligje dhe akte të tjera nënligjore. E drejta në pronë është e drejtë themelore e çdo njeriu dhe askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga kjo e drejtë, siç thuhet edhe në nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut: “secili ka të drejtë të ketë pasuri, vetë dhe në bashkësi me të tjerët dhe askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij/saj”.

Në këtë temë fokusi është në analizimin e legjislacionit nacional dhe sqarohet e drejta e gruas në pronë me fokus në risitë që sjellë Drafti i Kodit Civil i Republikës së Kosovës. Korniza ligjore në Republikën e Kosovës është mjaft mirë e avancuar sa i përket rregullimit të së drejtës së gruas në pronë, por zbatimi në praktikë ka mjaft ngecje dhe po paraqitet si një sfidë vështirë e evitueshme. Përveç analizimit të së drejtës materiale, gjatë këtij punimi analizohet edhe ana praktike, përkatësisht zbatimi i kornizës ligjore në praktikë, duke krahasuar dhe analizuar raste dhe vendime nga gjykatat e ndryshme të vendit tonë, dhe më gjerë.

Gjatë punës sime për këtë punim diplome kam përdorur metodën e analizës teorike, metodën statistikore, metodën e krahasimit, metodën e analizës, metodën e studimit të rastit, anketa dhe intervista.

Si përmbledhje, kjo temë konkludon sfidat më të cilat përballen gratë në fitimin dhe mbrojtjen e të drejtës në pronë, përmes trashëgimisë apo në forma tjera, hulumtimi i zbatimit të kornizave ligjore që rregullojnë këtë fushë në praktikë, dhe ky punim vë në pah se është e domosdoshme të anashkalohej zakonet dhe traditat në mohimin e të drejtës së gruas në pronë dhe të adresohen çështjet e ndërlydhura me të drejtat trashëgimore të grave për pronën e paluajtshme në Kosovë.